

VENDIM
Nr.843, datë 30.12.2005

PËR SHKARKIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRISË “VEFA” NË ADMINISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7/8 të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Z. Nasip Ahmeti dhe z. Saba Duckollari, administratorë të shoqërisë “Vefa”, në administrim, shkarkohen nga detyra e administratorit.

2. Ngarkohet grupi mbikëqyrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha